- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[**Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit**]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5

SPECIFIKIMET TEKNIKE

OBJEKTI DHE QELLIMI I SHERBIMEVE: *“RUAJTJA DHE SHOQERIMI I VLERAVE MONETARE PËR DREJTORINE RAJONALE OSSH DURRES”*

Specifikime teknike

Te realizohet sherbimi e shoqerimi i vlerave monetare si me poshte me :

Zyra te Sherbimit ndaj Klientit **[KNK]** dhe Arkat.

-Grupi i shoqerimit duhet te jete pajisur me mjete mbrojtese, me Uniforme dhe Dokument Identifikimi si dhe mjete te tjera logjistike sic parashikohet ne Ligjin Nr.75/2014 ”Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike”.

-Te shoqeroje vlerat monetare qe i jane besuar dhe te siguroje jeten e personelit gjate transportit te vlerave monetare.

-Per transportin e vlerave monetare, Ofertuesi duhet te pajise punonjesit e sherbimit me arme krahu, sipas pecaktimeve ligjore te Ligjit Nr.75/2014 ”Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike”.

Ofruesi i Sherbimit duhet te plotesoje kerkesat e meposhteme :

- a) Te jete i Licencuar nga autoritetet kompetente per ushtrimin e Funkcionit si roje i ruajtjes dhe Sigurise Fizike **(Kopje e Licences)**
- b) Te reflektoje nje sjellje korrekte dhe te respektueshme .
- c) Mjeti i identifikimit i punonjesve te sherbimit gjate gjithë kohes se Sherbimit duhet te mbahet ne vend te dukshem.
- d) Gjate gjithë kohes se Sherbimit punonjesi i Kompanise SHPSF , duhet te respektojë rregullat e brendeshme te OSHEE sh.a.
- e) Punonjesi i Ofruesit te Sherbimit duhet te jete i afte te reagoje dhe veproje gjithmone ne perputhje me Instruksionet e personave pergjegjes te percaktuar nga OSHEE sh.a.
- f) Te gjithë punonjesit e Ofruesit te Sherbimit te kerkuar duhet te jene te pajisur me Uniformen dhe te gjitha materialet e nevojeshme llogjistike sipas Ligjit Nr.75/2014 ”Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike” te publikuar ne Fletoren Zyrtare te dates 08.08.2014 , si dhe cdo Akti tjetër Nen / Ligjore perkatese qe del per SHPSF.
- g) Te kerkojne nga punonjesit te zbatojne rregullat e brendeshme te Objektit.
- h) Transporti i mjeteve monetare do te kryhet dy here ne dite, sipas vendodhjes se arkës se percaktuar ne tabelen e Shtojces Nr.1 .
- i) Transporti do te kryhet ne perputhje me Legjislacionin ne fuqi.
- j) Mjeti dhe numri i punonjesve qe do te kryejne sherbimin e transportit te vlerave monetare do te behet ne perputhje me Legjislacionin ne fuqi si dhe cdo Akti tjetër Nen / Ligjore perkatese qe del per SHPSF.
- k) Oraret e levizjes do te jene: Koha orare e shoqerimit te vlerave monetare do te jete :

-
- Turni i pare nga ora 14:00-16:00
 - Turni i dyte nga ora 19:00-21:00

l) Shoqërimi do të kryhet nga dita e hënë deri ditën e shtunë në të gjitha pikat sipas tabelës në shtojcen NR.1

m) Shoqërimi duhet të kryhet nga një mjet i kompanisë së shoqërimit, mjeti duhet të jetë i blinduar, i loguar, në gjendje të rregullt teknike dhe dokumentare për kryejën e shoqërimit të vlerave monetare.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet me objekt: "Shoqërimi i vlerave monetare për Rajonin Durrës për një periudhë 2 vjeçare"

1. Marrëveshje Kuader me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 24 (njetëzet e katër) muaj (i parashikuar)

Sherbimi do të kryhet në përputhje të plotë me Grafikon e mëposhtem:

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi kërkohet të kryhet në këto vende dhe sipas turneve në tabelë nga dita e hënë deri ditën e shtunë:

1.Durrës KNK 1 (fly)	Turni i Pare	Turni i dyte
2.Durrës KNK 2 (njesia)	Turni i Pare	Turni i dyte
3.Durrës KNK 3	Turni i Pare	Turni i dyte
4.KNK Kavaje	Turni i Pare	Turni i dyte
5.KNK Kushe Kruje	Turni i Pare	
6.Kruje ARKE	Turni i Pare	
7.KNK MANZE	Turni i Pare	
8.KNK SHIJAK	Turni i Pare	Turni i dyte
9.KNK Rrogozhine	Turni i Pare	
10. KNK Golem	Turni i Pare	

Afati i Sherbimit: 24 (njetëzet e katër) muaj.

Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuader me Operatorin Ekonomik shpallur fitues nga kjo procedurë prokurimi, sipas përcaktimit të Autoritetit Kontraktor me afat përfundimtar 24 muaj.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

1. Objekti dhe Qellimi i Sherbimeve :

“Ruajtja dhe shoqërimi vlerave monetare Drejtoria Rajonale e OSSH Durres - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj.

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2. Objektivat:

Ofertuesi i Sherbimit do te siguroje ruajtjen dhe shoqërimin e vlerave monetare te KNK-ve dhe Arkave te Drejtorise Rajonale te OSHEE Durres si dhe punonjesit (arketare) gjate kohes qe ata jane duke performuar detyrat e tyre ne keto ambiente të KNK-ve dhe Arkave sipas Tabelës së Shtojcës 6.

3. Detyrat e Kontraktorit:

Kontraktori ka për detyrë:

2. Cdo punonjes i Sherbimit, Titullari i Subjektit te SHPSF-se, si dhe Drejtuesi Teknik duhet te kryejne me pergjegjesi te gjitha detyrat e percaktuara ne Ligjin Nr.75/2014 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike” te publikuara ne Fletoren Zyrtare date 08.08.2014, si dhe ne Aktet Nenligjore te dala ne zbatim te tij.
3. Ruajtja dhe shoqërimi i vlerave monetare të mbledhura nga KNK dhe Arkat do të bëhet çdo ditë nga e Hëna në të Shtunë nga vendndodhja e KNK dhe Arkave deri në bankat respektive me të cilat ka kontratë OSHEE sh.a.
4. Gjithashtu Ofruesi i Shërbimit do të sigurojë ruajtjen fizike të punonjësve të KNK dhe arkave (arkëtarët) gjatë kohës që ata janë duke përformuar detyrat e tyre në ambientet e OSHEE, Drejtoria Rajonale Durres si dhe gjatë transportit të vlerave monetare deri në përfundim të dorezimit të këtyre vlerave pranë bankave respektive.

Koha e Shërbimit:

Operatori Ekonomik duhet te ofroje sherbimin e kerkuar nga e hena ne te shtune perkatesisht :

- Turni i pare do te kryhet nga Ora 14.00 - 16.00
- Turni i dyte do te kryhet nga Ora 19:00 - 21:00

Shperndarja

Sipas tabelës se publikuar nga Autoriteti Kontraktor ne kete DST.

Vendi dhe kryerja e sherbimeve :

Arkat dhe Qendrat KNK te Drejtorise Rajonale te OSHEE Durres si dhe bankat respektive ku do te behet derdhja e vlerave monetare .

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e ofertes ekonomike.*

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor),

2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Licensën e Shoqërisë (te vlefshme) lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për ushtrimin e aktivitetit të Kategorisë “1.3.B”, konform Ligjit Nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me Ligjin Nr.10137 dt. 11.05.2009, Ligjit Nr.75/2014 “Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhezimit Nr.130 dt. 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme “Për Funksionimin e Sherbimit Privat të Sigurisë Fizike”.

2.1.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **Çertifikatën e Titullarit të Subjektit të Shoqërisë e cila duhet të jetë e vlefshme dhe t’i përket ushtrimit të aktivitetit të Kategorisë “1.3.B”,** konform Ligjit Nr.75/2014 “Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhezimit Nr.130 dt. 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme “Për Funksionimin e Sherbimit Privat të Sigurisë Fizike”.

2.1.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **Çertifikatën e Drejtuesit Teknik të Shoqërisë e cila duhet të jetë e vlefshme dhe t’i përket ushtrimit të aktivitetit të Kategorisë “1.3.B”,** konform Ligjit Nr.75/2014 “Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhezimit Nr.130 dt. 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme “Për Funksionimin e Sherbimit Privat të Sigurisë Fizike”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë:

2.2.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuar të bilanceve të tre viteve të fundit 2018, 2019, 2020 të konfirmuara me vule pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e mëposhtme “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3 Operatori ofertues duhet të paraqesë Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit (Gusht – Shtator – Tetor 2021), shoqëruar me **listë pagesat e sigurimeve shoqërore** (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë, ku te jene te siguruar ne listpagese emrat e 16 punonjesve te çertifikuar qe do te realizojne sherbimin, si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. *Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në kete rast, vlera e kerkuar eshte në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që prokurohet që është realizuar gjatë tre viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasitë e shërbimeve te realizuara ose fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasitë e shërbimeve te realizuara.

ose

b - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve te realizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqese Autorizim Individual (*te vlefshem*) në emër të shoqërisë për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike (AKEP) konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ne te cilen te kete fushe mbulimi me fushe mbulimi ne qarkun ose qytetet ku ndodhen objektet.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te disponoje Qender Kontrolli te Sherbimit (Salle Operative) 1.3.B me adrese te percaktuar sakte. Qendra e Kontrollit te jete e pajisur me sistem ndërlidhës, radiokomunikim, qe te bëjnë të mundur sigurimin e pandërprerë të radiondërlidhjes pranë çdo objekti. Bazuar ne nenin 22 te Ligjit Nr.75/2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe ne Kreun VII, pika 5 te Udhëzimit të Ministrisë të Brendshëm Nr.130, datë 05.03.2018 "Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike"; Operatori Ekonomik te paraqese akt miratimi te vlefshem te leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Durres dhe Tirane. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te beje verifikimin ne terren te ekzistences se salles operative.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim performance leshuar ne jo me pare se muaji Qershor i vitit 2021 nga Drejtoria e Policise se Durres per kategorine e Licences 1.3B, konform ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) te ndryshuar si dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij. Ku duhet te jepet informacioni per disponimin e:

- Qendra e kontrollit te Sherbimeve (salle Operative)
- Te kete jo me pak se 10 punonjes te licensuar,
- Te kete jo me pak se 6 Arme te kategorise (B4) dhe 4 Arme te kategorise (B1)
- Te kete jo me pak se 10 cope shkopinj gome, jo me pak se 10 cope pranga lidhese, jo me pak se 10 cope jeleke antiplimb.

-
- Te mos kete masa administrative, shkelje te konstatuara te marra nga Drejtoria Vendore e Policise Durres sipas percakimeve te ligjit 75\2014 per sherbimin privat te sigurise fizike dhe udhezimit te ministrit te brendshem nr 130 date 05.03.2018 per funksionimin e sherbimit privat te sigurise per vitin 2020 e ne vazhdim.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim performance leshuar ne jo me pare se muaji qershor i vitit 2021 nga Drejtoria e Policise se Tirane per kategorine e Licences 1.3B konform ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) te ndryshuar si dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij. Ku duhet te jepet informacioni per disponimin e:

- Qendra e kontrollit te Sherbimeve (salle Operative)
- Te kete jo me pak se 6 punonjes te licensuar,
- Te kete jo me pak se 4 Arme te kategorise (B4) dhe 2 Arme te kategorise (B1)
- Te kete jo me pak se 6 cope shkopinj gome, jo me pak se 6 cope pranga lidhese, jo me pak se 6 cope jeleke antiplimb.
- Te mos kete masa administrative, shkelje te konstatuara te marra nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane sipas percakimeve te ligjit 75\2014 per sherbimin privat te sigurise fizike dhe udhezimit te ministrit te brendshem nr 130 date 05.03.2018 per funksionimin e sherbimit privat te sigurise per vitin 2020 e ne vazhdim

2.3.6 Operatori Ekonomik te kete ne pronesi jo me pak se 16 Arme te Kategorise 1.3 B nga te cilat 10 arme te kategorise B4 dhe 6 arme te kategorise B1 dhe per kryerjen e sherbimit te kerkuar. Per te vertetuar faktin e pronesise se armeve duhet te disponoje dokumentacionin si me poshte:

- Autorizim për blerje armësh lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit.
- Kontrate shitblerje arme me nje shoqeri te licensuar per shitblerje armesh shoqeruar me numrin serial te armeve.
- Faturat tatimore per blerjen e armeve / deklarate doganore te mallit.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 8 automjete te blinduara ne emer te shoqerise ose me qera per transportin e vlerave monetare. Mjetet e blinduara duhet te jene te pajisura me:

- Certificate pronesie.
- Lejet e qarkullimit nga Drejtoria e Transportit Rrugor per cdo mjet.
- Marrja me qira ose huaperdorja e automjeteve te mesiperme, do te pranohet nese kontrata/t e qiramarrjes / huaperdorjes jane te lidhura para noterit, me afat vlefshmerie brenda afatit te zbatimit te kontrates per kete sherbim, te shoqeruara me dokumentacion (certificate pronesie, leje +qarkullimi, siguracion dhe akt kolaudimi te vlefshem). Ne rast te mjeteve në përdorim apo me qera, në autorizimin përkatës te Drejtorit te Pergjithshem te Policise se Shtetit te jete shënuar emri i perdoruesit apo qeramarresit. (Referuar Udhëzimit te Përbashkët te Ministrit të Brendshëm Nr. 1362/2 Prot date 29.05.2006 dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit me Nr.5495 Prot dt.31.05.2006 “Për karakteristikat konstruktive dhe funksionale të mjeteve të blinduara”.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 8 Leje drejtimi te perdoruesit te mjetit te blinduar, 8 Siguracione te vlefshem te automjeteve sipas lejeve te qarkullimit te deklaruar dhe Vertetim per taksat e paguara per 8 automjete sipas lejeve te qarkullimit.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 8 Autorizime te vlefshme per perdorimin e mjeteve te blinduara sipas lejeve te qarkullimit te deklaruar te leshuara nga Drejtori i Pergjithshem i Policise se Shtetit (te vlefshem per vitin 2021 e ne vazhdim), ku te jene percaktuar emri i shoqerise, te dhenat e mjetit dhe afati i vlefshmerise.

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet te kete 8 certifikata te leshuara nga prodhuesi i mjetit te blinduar per normen e blindimit ku te referohet se te gjitha automjetet e blinduara jane te Kategorise BR 6 sipas normes europiane UNI EN 1063 dhe kategoria FB4+ per normen europiane UNI EN 1522, ose me standarte te ngjashme me to, ne zbatim te Udhhezimit Nr.130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem “Per Funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”, botuar ne Fletoren Zyrtare ne date 09.03.2018.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 2 (dy) kuti (valixhe) per mbajtjen e bankonotave me boje ngjyrosje per perballimin e situatave te emergjencave. Per te vertetuar kete operatori duhet te paraqese faturen tatimore per blerjen dhe pagesen qe verteton vleren e blerjes ose deklaraten doganore te mallit. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te beje verifikimin ne terren te ekzistences se valixheve per mbajtjen e bankonotave.

Operatorët Ekonomikë duhet te paraqesin analizen e kostos per oferten e paraqitur. (Shih Shtojca 2 - Sqarime)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet /Mallrat e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:

	Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një	Po []

Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës.	
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).	Po [] Jo []
8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me : a) çmimet; b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.	Po [] Jo []
9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës,	Po [] Jo []

përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.	
10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	Po [] Jo []

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike. Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të

zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005.

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [] Jo []
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [] Jo []
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga	Po [] Jo []

ISHPSHSH.	

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

Data e dorëzimit të deklaratës _____ Vula _____

Emri, Mbiemri, Firma _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, **një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit** duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

Shënim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

Formulari i Njoftimit të Skualifikimit 2

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit të njoftimit të fituesit sipas parashikimeve në Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor

²Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore

Shtojca 11

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit:

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera

—
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

*Emri i plotë i shoqërisë
mëposhtme*

Numri i NIPT-it

arsyet e

2. _____

*Emri i plotë i shoqërisë
mëposhtme*

Numri i NIPT-it

arsyet e

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej _____ [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

[Titullari i Autoritetit/entit Kontraktor]

Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 3

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, Sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës] Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it
arsyet

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it
arsyet

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

³ Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

[Titullari i autoritetit /Entit kontraktor]

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>Numri i NIPT-it</i>

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>Numri i NIPT-it</i>

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____
e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra _____

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra _____

Etj. _____

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

[Drejtuesi i Autoritetit /Entit Kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR
(PAS PROCESIT TË ANKIMIT⁴)**

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të kësaj bëjmë me dije se në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>Numri i NIPT-it</i>

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>Numri i NIPT-it</i>

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

⁴ Ky Formulari është i aplikueshëm nëse ka ankime

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra _____

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) _____

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra _____

Etj. _____

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqisni tek [emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor] sigurimin e kontratës brenda _____ ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Ankesat: (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr dhe datë) _____

[Titullari i Autoritetit /Entit Kontraktor]

Seksioni III Termet dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

Ky Seksion përmban :

Shtojca 15: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 16: Kushtet e Veçanta të Kontratës

Shtojca 17: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 18: Draftmarrëveshje kuadër ku përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 19: Draftmarrëveshje kuadër ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 15

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Neni 1 Dispozitat e përgjithshme

1.1 Përkufizimet

